PROCESVERBAL 27/2024

I mbajtur me rastin e takimit të 11 (njëmbëdhjetë) të rregullt për vitin 2024 të Komunitetit për Komunitete, mbajtur me datë 27.11.2024 duke filluar nga ora 9:00.

Rend dite

1.Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

2.Shqyrtimi i projekt-vendimit për dhënien e pëlqimit për të zhvilluar procedurat përmes konkurrimit të hapur për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës;

3.Shqyrtimi i projekt-vendimit për shpalljen e interesit të përgjithshëm;

4.Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e kërkesave;

5.Të ndryshme;

Takimin e hapi kryesuesi i komisionit Denis Sofra dhe i njoftoi me rendin e ditës.E hedh në votim rendin e ditës.

Aprovohet rendi i ditës

Pika 1. **Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**

Denis Sofra - e hedh në votim pikën 1.

Aprovohet pika 1

Pika 2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për dhënien e pëlqimit për të zhvilluar procedurat përmes konkurrimit të hapur për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës;

Denis Sofra - i njofton me pikën dhe thotë që është një vendim për dhënien në pëlqimit për 99 vite me sip. 348 m² i quajtur si pronë fshat e cila është e evidentuar me emër të komunës dhe sipas HZK-së parashihet të ndërtohet objekt afaristo banesor në Suharekë.Ky projekt-vendim ka kalu në KPF dhe mbetet prej nesh si anëtar të Komitetit me dërgu në Kuvend.E hedh në votim pikën 2.

Aprovohet pika 2

Pika 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për shpalljen e interesit të përgjithshëm;

Denis Sofra - i njofton me pikën dhe thotë që ky projekt-vendim është në interes të komunës për ndërtimin dhe rregullimin e infrastrukturës në rrugën "Luigj Nikolla" në Suharekë dhe bëhet fjalë për një pjesë e cila është 55 m²,zonë kadastrale e quajtur Pojata dhe e evidentuar në emër të Sevdije Osman Berisha.E hedh në votim pikën 3.

Aprovohet pika 3

Pika 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e kërkesave;

Denis Sofra - i njofton me pikën dhe thotë që në këtë projekt-vendim janë tri kërkesa të ndryshme të cilat i janë adresuar komunës për ndihmë financiare për arsye të djegjes së shtëpive.E hedh në votim pikën 4.

Aprovohet pika 4

Pika 5.Të ndryshme;

Denis Sofra - hap debatin.
Nazim Shabanaj - fëmijët që po shkojnë në shkollë në mëngjes janë të rrezikuar shumë prej qenve.
Është mirë me bo një kërkesë që me zgjidh këtë problem sepse jemi të rrezikuar,dhe jo vetëm fëmijët por edhe ne sepse po duhet ti dërgojmë në shkollë fëmijët.
Denis Sofra - ky problem nuk është vetëm në fshatin Gelancë por është problem në tërë territorin e Kosovës.Nuk e di ku ka arrit niveli qëndror rreth kësaj problematike.Këtë kërkesë mund ta paraqesim në KKSB ku është prezent komandanti i policisë dhe Drejtori i Bujqësisë dhe ndoshta e merr një përgjigje më adekuate.

Takimi përfundoi: 09:12